


VITI XIV, NUMRI 5 / MAJ 2010

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA





# Një ndër pesëdhjetë mijë

**N**jë ditë kur pashë kalendarin e punës së katër muajve të kaluar m'u kujtua përsëri që sa fat i madh është që jemi pjesë e një biznesi kaq të mrekullueshëm. Megjithëse ka kaluar vetëm çereku i parë i vitit 2010, kemi plotësuar dhe arritur shumë gjëra. S'kemi shumë kohë që jemi kthyer nga stacioni i Rallyt European. Ishte me të vërtetë i mrekullueshëm. Në Arenën Wembley të Londrës u organizua për herë të dytë Rally European. Aktiviteti na kujtoi herën e parë kur ishim aty në vitin 1998. Kanë ndodhur ndryshime të shumta prej asaj kobe. Në Arenën Old Wembley ishim afërsisht dymijë vetë, i cili ishte një numër madhështor në atë kohë. Dhe atëherë aty ishin shumë prej nesh që e ndjenë veten të lumtur mes 2000 distributorëve. Edhe atëherë më kujtohet që po mendoja se si mund të bëhemi më shumë dhe më të mirë se kaq. Arrita në përfundimin që akoma më shumë njerëz nga Europa duhet të dëgjojnë rreth këtyre produkteve të shkëlqyera dhe planit tonë të biznesit. Dhe gjëja me të vërtetë e mrekullueshme që ishim përsëri në Londër ishte fakti që pas dymbëdhjetë vitesh, tani ishim të pranishëm 10000 distributorë. Përjetimi i rritjes – jo vetëm në numër, por edhe në profesionizëm dhe angazhim – më mbush me të vërtetë me frymëzim. Shpresoj që ju që ndodheshit aty me mua e ndjetë njëlloj forcën e FOREVER-it. Bob Paker-it dhe skuadrës së tij mund t'ju them vetëm që ky ishte Rally European më i mirë deri tani. E ngriti shumë nivelin. Ndamë shpërblime me vlerë prej disa miliona dollarësh mes 208 plotësuesve të Profit Sharing. Ishim dëshmitarë të disa mijëra kualifikimeve dhe morrëm edhe një trainim special nga „Diamantët” e Europës. Çfarë fundjave! Duke u kthyer për në shtëpi po mendohesha se çfarë na mësoi kjo ekperiencë e Londrës? Ekzistojnë momente kur mendon për biznesin tënd dhe thua që: gjithçka është në rregull, gjithçka shkon siç duhet. Bën shumë para, shijon stilin e jetës për të cilën ëndërroje. Dhe kjo është në rregull. Por duhet të tregohemi të kujdesshëm që të mos fundosemi në këtë gjendje. Tek secili prej nesh ekziston mundësia për të arritur diçka akoma më të madhe. Duhet ta vazhdojmë këtë rrugë, duhet të dallojmë dhe të ëndërrojmë gjëra më të mëdha. Kjo nuk do të thotë që të mos shijojmë atë që kemi arritur dhe që zotërojmë. Por të mos harrojmë që asnjëherë nuk duhet të ndalojmë në një vend. Ky është një gabim i shpeshtë në këtë biznes. Disa prej nesh ndalojnë kur e arrijnë rezultatin që i venë vetes si pikësynim. Dhe nuk kryejnë as ato gjërat e thjeshta që e sollën deri këtu. Mos harroni: kur s'ka rritje fillon rënia.

Pra pyetja është: si të rritemi?

**1. Durim** – Duhet të kuptojmë se rritja nuk mund të matet gjithmonë me numra. Ekzistojnë periudha kur bën gjithçka, por prapë të duket se gjërat nuk funksionojnë. Nëse në këtë kohë nuk dorëzohesh, kjo do të jetë periudha kur rritesh më shumë. Mos harro që nevojitet kohë në mënyrë që rezultatet të bëhen të dukshme.

**2. Shkaku** – “Përse-ja” jote. Shkaku që përse punon duhet të jetë më i madh se sa rezistenca me të cilën do të takohesh me çdo kusht. Përsëmbull nëse faktori motivues është një sasi e caktuar parash, atëherë kur e përvetëson atë të merr fund menjëherë motivimi, nëpërmjet të cilit deri tani ishe në gjendje të luftoje. Pra “përse-të” e tua duhet të jenë personale dhe emocionale. Ky lloj motivimi është i pafund. Një analogji: sa e do nëna fëmijën e vet? Pafund! Në një program televiziv më pyetën që çfarë personaliteti nevojitet që dikush të bëhet distributor i suksesshëm. Kjo është pyetja të cilës mund t'i përgjigjem pa u menduar aspak: nëse merresh me të tjerët më shumë se sa me vetveten, atëherë mund të bëhesh distributor i shkëlqyer i FOREVER-it.

**3. Qëndro pozitiv!** Çfarëdo të ndodh, buzëqesh dhe qëndro njeri i gëzuar. Njerëzve u pëlqejnë personat pozitiv.

**4. Qetësohu dhe shijo jetën!** Ndiqe mirë veten. Nëse je i qetë mund të arrish gjithçka që dëshiron.

Pranë Arenës Wembley ndodhet Stadiumi Wembley me kapacitet prej 90000 njerëzish. Kur qëndroja në skenën e Arenës përpara publikut prej afërsisht dhjetë mijë vetësh, mendoja që ky është një numër shumë i madh distributorësh, por prapë s'është i mjaftueshëm. Sepse nëse në dhjetë vitet e ardhshme punojmë ashtu si në dhjetë vitet e kaluara, mund të mblihdhen edhe 50000 distributorë në stadiumin fqinj. Sa e mrekullueshme do të ishte? Pra po them që duke e vazhduar atë që kemi bërë deti tani me pak më shumë durim, qëndrim pozitiv dhe dëshirë, është e sigurt që mund të rritemi. Jo vetëm si distributor, por edhe si drejtues. Dhe në një ditë të bukur edhe Ti mund të ndodhesh mes 50000 vetësh.

  
REX MAUGHAN





# FESTOJMË ME *Rex-in!*

*Maji i 2010-ës sjell një radhë të tërë festash në jetën e punonjësve të ë Forever-it. Natyrisht festa më e rëndësishme është përvjetori ynë i 13-të të cilin sivjet e festojmë së bashku me krijuesin dhe drejtuesin e përgjithshëm të Forever Living Products, Rex Maughan, dhe drejtuesin e Europës, Aidan O'Hare, më 6 qershor në Arenën Sportive të Budapestit.*

*Çfarë do të thotë të festosh së bashku me Rex-in? Jeta, veprimtaria dhe puna e Rex Maughan është simboli i Forever-it. Çdo buzëqeshje, hap dhe lëvizje të tij e ndjekin dhe e respektojnë dhjetra mijëra njerëz. Mendimet dhe deklaratat e tij kanë ndryshuar dhe do të ndryshojnë jetën e miliona njerëzve për dhjetëvjeçarë me radhë. Pasi krijoi një sistem që funksionon në mënyrë të përsosur, i cili është prej 32 vitesh sistemi Multi Level Marketing më i mirë në botë. Është e vështirë të jesh i përsosur, dhe të mbetesh njëkohësisht modest dhe i sigurt në vetvete. Ai këtë e bën me lehtësi duke buzëqeshur dhe me gjithë qejf në çdo moment të jetës së tij. Personaliteti i tij rrezaton një vendosmëri dhe forcë fantastike, kalimi i sikur edhe disa minutave me të në skenë na jep një forcë të madhe për zgjidhjen e problemeve që na qëndrojnë përpara. Për mua Ai është Shembulli dhe Sponsor i im, prej Tij kam mësuar dhe mak marrë më shumë nga të gjithë. Dhe këtë dëshiroj t'ia shpërblej duke mësuar të tjerët që të mësojnë nga Rex-i. Por më 6 qershor do na mësoj vetë ai! Ta dëgjojmë që çfarë mesazhi na jep, dhe t'i ndjekim këshillat dhe udhëzimet e tij, sepse e ndjen biznesin, mirësinë dhe jetën.*

*Në maj ka lindur një nga djemtë e Rex-it, Gregg Maughan, presidenti i firmës sonë. Na vjen mirë kur shikojmë se tiparet dhe karakteristikat e Rex-it trashëgohen, dhe që titullin e presidentit e morri personi i duhur! Të urojmë Gëzuar Ditëlindjen, Zoti President!*

*Dhe natyrisht në maj festojmë nënat tona, megjithëse Ato duhen festuar dhe dashur në çdo ditë të vitit! Dhe lash në fund të ardhmen, më të dashurit, fëmijët! Në këtë muaj festojmë Ditën Botërore të Fëmijëve. Ata përbëjnë përparimin, zhvillimin, bashkimin dhe dashurinë!*

*Majit tonë sivjet i përshtatet me të vërtetë mesazhi i Rex Maughan: forca e Forever-it është forca e dashurisë!*

*Takohemi me Rex Maughan-in më 6 qershor në Arenën Sportive të Budapestit!*

*Përpara, FLP Hungari!*

DR. SANDOR MILESZ  
DREJTOR GJENERAL



DITA E SUKSESIT - DEBRECEN

# Success Day

## DITA E SUKSESIT KTHEHET NË SHTËPI

**Distributorët e Debrecentit janë të gëzuar dhe të entuziazmuar. Dita e Suksesit kthehet në shtëpi! – thonë. U përgatitën me krenari dhe dashuri aq të madhe për këtë aktivitet, ashtu siç përgatitet njeriu kur pret në shtëpi fëmijën e tij që ndodhet larg dhe ka bërë famë.**

**P**o, pas shumë vitesh Forever e feston në Debrecent Ditën e Suksesit. Aty ku fillimisht hodhi hapin e parë, dhe duke u nisur që këtu i bashkoi në unitet vëllazëror popujt e Europës. Në një njësi të suksesshme që funksionon mirë, e cila është shembull për rajonet e tjera të Europës.

Në skenë programi hapet nga muzika dinamike dhe kërcimi akrobat i **Grupit Muzikor dhe Kërcimtar Android**. Shfaqja spektakolare dhe gazmore tërheq gjithmonë e më shumë shikues.



Kur në skenë shfaqen senior menaxheret **Tünde Hajcsik** dhe **Patricia Rusak** që si drejtuese programi të përshëndesin të pranishmit, duartrokiten nga salla e mbushur plot.


I pari që thërrasin në skenë është njeriu i cili është motori i sukseseve tona, i cili na udhëhoqi në krye të Europës, dhe i cili e ruan me sukses rolin e drejtuesit: drejtori gjeneral **Dr. Sandor Miliesz**. Në përshëndetjen e tij lavdëron punën dhe entuziazmin e distributorëve të Debreçenit dhe rrethit Hajdu-Bihar, si rezultat i të cilit erdhi në jetë Dita e Suksesit të Debreçenit. Me këtë rast me lajme të mira e ndez akoma më shumë këtë entuziazëm. Deklarata e mëposhtme e drejtorit gjeneral tregon që tek Forever-i edhe paraja ka më shumë vlerë! Pasi nga kjo ditë në Forever 265 Forinta kanë vlerën e një Euroje. Është i kuptueshëm entuziazmi i publikut! Lajmi tjetër i mirë është që doli përsëri në treg libri i njohur me titull „Pastër dhe thjeshtë”. Si përfundim drejtuesi ynë u uron të pranishmëve mësim dhe argëtim të mbarë.





Menaxherja **Dr. Emese Dezsényi** konsiderohet si një ndihmëse e vërtetë nga ata që e njohin. Karriera e saj është shembull edhe si mjeke, edhe si menaxhere. Leksioni i saj profesional përmbledh mundësitë e mposhtjes së lodhjes pranverore. Na jep një pamje të shkurtër dhe të qartë rreth shkaqeve të krijimit të kësaj gjendje të pakëndshme. Nëse mendojmë për plotësuesit ushqimor të Forever-it këshillat e dietës dhe mënyrës së jetesës së doktoreshës i japin leksionit një tingëllim pozitiv.

Senior menaxheren **Dr. Anna Schmitz** e kaluara dymbëdhjetëvjeçare në Forever e shtyn të bëj pak nostalgji me rastin e Ditës së Suksesit që kthehet në shtëpi në Debrecen. Tregon mbresa shumë të bukura. Pastaj thërrret në skenë kolegët e pranishëm që punojnë në shëndetësi që të ndajnë me të intersuarit përvojat e tyre praktike me produktet. U pasuruam me përvoja të shumta bindëse dhe me vlerë. Vlerësohet shumë sidomos përvoja që bën fjalë rreth bashkëpunimit shembullor të mjekimit tradicional dhe mënyrës së jetesës Forever në interes të shpëtimit të jetës së një fëmije.





Pas vëmendjes dhe përqëndrimit të tensionuar të deritanishëm, meritojmë pak argëtim. Fillimisht në skenë shfaqen kërcimtarët e **Studios së Kërcimit të Barkut Esztella**, grup i cili mund të krenohet edhe me suksese ndërkombëtare. Shfaqja fantastike i lë me gojë hapur shikuesit. Harruam edhe të duartorkasim! Pastaj kur e kuptojmë se çfarë pamë, shpërthen brohoritja. Kurse **Tünde Hajcsik** si drejtuese programi nuk harron t'u tërheq vëmendjen debrecenasve që kërcimtarja Eva Agoston me votat e dërguara në adresën e-mail [flpcsillaga@flpseeu.hu](mailto:flpcsillaga@flpseeu.hu) mund kualifikohet në konkursin e zbulimit të talanteve të Forever-it.

**Sandor Enyedi** dhe grupi i tij muzikor e ngre akoma më lart atmosferën me këngë angëtuuese ritmike, pastaj shfaqjet argëtuuese ndiqen nga pika kulminante e Ditës së Suksesit, dhënia e kualifikimeve. Drejtori rajonal i Szekesféhervarit **Tibor Kiss** thërret në skenë supervisorët dhe asistent menaxherët që të marrin medaljet e tyre nga drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz**.





Soaring menaxheri dhe këshilltari mjek i Forever-it, **Dr. Endre Nemeth**, me këtë rast flet rreth ndërtimit të biznesit. Pikëpamja e tij personale e shoqëruar me humorin e tij karakteristik i jep një forcë të veçantë bindëse. Në leksionin e tij me titull „Profiti është i imi” prezanton kënaqësitë (por edhe vështirësitë) e rrugës që e çoi drejt çekut të bukur të Ndarjes së Profitit që morri radhën e fundit. E përgëzojmë dhe përipiqemi ta ndjekim!

Pas leksionit skena u kthye në sallon bukurie. Me drejtimin e senior menaxheres **Tünde Hajcsik dhe Patricia Rusak** filloi **SONYA-show**. Në skenë mjeshtrit e zotë të Qendrës SONYA – kozmetik, manikyrist, paruker... - prezantojnë në praktikë efektet me të vërtetë të bukura të produkteve kozmetike Sonya. Dejtueset e programit ndërkohë krahas pamjes japin edhe njohuri. Dëgjojmë informacionet, argumentet dhe faktet kryesore të cilat përbëjnë çelësin e suksesit të produkteve SONYA në treg. Siç u shprehën: kështu bëhen pikë nga bukuria.







Ndërkohë që shikuesit magjepsen nga modelet Sonya të përgatitura bukur, **Grupi Muzikor dhe Kërcimtar Android** na shërben me këngë të shoqëruara me kërcime koreografike. Programi vazhdon me dhënien e kualifikimeve. Me këtë rast në skenë grumbullohen anëtarët e Klubit të Sundimtarëve dhe distributorët që kanë arritur nivelin e menaxherit, si dhe ata që kanë plotësuar programin motivues të makinës, të shoqëruar nga brohoritja entuziasmuese e publikut. Lektorit që vjen prezantohet në skenë si njeriu i cili ka arritur gjithçka që mund të arrihet si safir menaxher. **Istvan Utasi**, siç e thotë edhe vetë, motivohet nga mësimi dhe zhvillimi i vetvetes. Prandaj nuk heq dorë kurrë nga kërkimi dhe përvetësimi i gjërave të reja. Sqaron që në fillim të leksionit të tij me titull Ndryshim do të flasë rreth „ndryshimit të vërtetë”. Nuk e fsheh që për të siguruar dhe për të mbajtur vlerat e vërteta duhet luftuar. „Lajmi i mirë është – shprehet ai – që varet nga aty se çfarë arrin!”





Safir menaxheri **Jozsef Szabo** flet në skenë rreth asaj që flasin të gjithë në sallë, në korridor dhe pikat e shitjes: „u ktheva në shtëpi”! Jozsi – siç e thërrasim mes njëri tjetrit – fluturon dhe ndriçon në skenë. U kthye në shtëpi, aty ku mësoi pavarësinë. Aty ku realizoi ëndrrat, pikësynimet e tij... vetveten. Nga u nis dhe ndihmoi shumë njerëz. Cila është në të vërtetë shtëpia për të? Debreceni? Forever? Pavarësia? E shikoj në skenë dhe kam përshtypjen që nuk duhet kuptuar, por duhet ndjerë ajo të rrezaton. Mendoj se e ndjej! Debreceni, pavarësia dhe Forever janë së bashku SHTËPIA për Jozsef Szabon. Po – e ndjej, e ndjejmë – që Forever është mundësia e NJERIUT për një jetë të denjë, për pavarësinë. Falemnderit, Jozsef Szabo!

Aktiviteti përfundon me kualifikimin e asistent supervisorëve, të cilët i marrin medaljet e tyre nga drejtori rajonal i Debrecenit, **Kalman Posa**, dhe ai i Szekesfehervarit, **Tibor Kiss**.

Pjesëmarrësit nisen për në shtëpi nga një Ditë Suksesi me atmosferë të veçantë. Këtë e vërtetojnë bisedat dhe opinionet që dëgjohen nga grupe të mëdha e të vogla që janë duke u larguar. Pothuasje të gjithë thonë të njëjtën gjë: duhet organizuar më shpesh Ditë Suksesi në Debrecen!



# Të dashur Shqiptonja të Reja!

**T**ë përshëndes me respekt dhe dashamirësi Ty që tani hyre në një firmë të vërtetë botërore. Të përgëzoj për vendimin tënd! Me siguri kishe shkak të mirë për të. Ndërkohë që mund të zgjidhje edhe nga produktet e firmave të tjera, mund të nisje biznes edhe në fusha të tjera ose me firma të tjera MLM. Me siguri të kanë bindur cilësia e produkteve tona dhe raporti i paparë i vlerës dhe çmimit. Kjo është gjëja e parë dhe më e rëndësishme. Ti me siguri e di edhe atë që tek Forever nuk je vetëm një blerës i thjeshtë. Ke sponsor, ke drejtues, drejtues të lartë, ke drejtor rajoni, drejtor gjeneral, drejtor të Europës: zëvendësdrejtorin e Forever-it të Amerikës. Ke ëndërruesin dhe krijuesin e firmës, Njeriun për të cilin mendojnë me respekt dhe falenderim me miliona njerëz në botë: Rex Maughan. Sipas teje ekziston në botë ndonjë firmë e cila i njeh të gjithë blerësit e saj dhe kujdeset personalisht me ta? A ka në botë ndonjë firmë ku çdo drejtues e konsideron çështje të rëndësishme të njihet me konsumatorët e tij, të flas me ta, t'i dëgjoj ata, të bisedoj me ta, t'i mësoj ata, t'i çoj ata në vendet më të bukura të Europës dhe botës? Ke dëgjuar rreth ndonjë firme e cila prej më shumë se tre dhjetëvjeçarësh, në afërsisht 150 shtete u siguron gjithë blerësve të saj mundësi të njëjta për krijimin e një biznesi privat të sigurt, të planifikueshëm dhe me afat të gjatë kohe, pa investim material dhe rrezik? Ke dëgjuar që blerësit dhe ndërtuesit e biznesit kanë vetëm të drejta, kurse firma ka vetëm detyrime ndaj anëtarëve të saj? A njeh ndonjë firmë ku gjatë 30 viteve sështë vonuar asnjë ditë në pagimin e parave dhe bonusave që u takojnë sikur edhe konsumatorëve të vegjël në datën 15 të çdo muaji, apo në pagimin e qindra mijërave dhe milionave që u takojnë ndërtuesve të rrjetit? Në botën e Forever-in ekzistojnë shumë „pyetje për t'u përgjigjur“. E di që edhe ti ke pyetje, madje si fillestar ke edhe dyshime. Jam dakort që në pamje të parë duket e bukur më tepër se ç'duhet. S'je i detyruar ta besosh. Njohjen e fakteve mund t'ia besosh eksperiencës personale. Pikërisht tani ujen nasti më i përshtatshëm për këtë. Më 6 qershor në Budapest, në Arenën Sportive Papp Laszlo organizojmë aktivitetin më të madh të Ditës së Suksesit, shfaqjen ekskluzive të përvjetorit të 13-të të Forever-it të Hungarisë dhe rajonit sllavo-jugor, ku presim mysafirë nga gjithë Europa juglindore. Është një nder dhe respekt i madh për ne që na viziton nga Amerika Rex Maughan dhe Aidan O'Hare! Përpiqu të sigurosh biletë hyrjeje! Këtu bëhet fjalë për të ardhmen Tënde.



**Tibor Radoczki**  
DREJTOR RAJONAL,  
SOARING MENAXHER





SARAJEVË

# Success Day

## LE TË FILLOJ SHOW!

**Në sallë fillon konkurimi i muzikës së këndshme të hapjes me gumëzhitjen herë të gëzuar, herë të emocionuar – por patjetër entuziaste – të të mbledhurve për në festë. Miq të mirë dhe të njohur të dashur të ardhur nga anë të ndryshme të kufirit takohen, shtrëngojnë duart me njëri tjetrin dhe i gëzohen këtij takimi.**

Vjen dreka dhe gumëzhitja e paparë e turmës së mbledhur ia lë vendin qetësisë së vëmendjes dhe interesimit. Në këtë kohë në skenë shfaqen drejtuesit e programit, senior menaxheret **Tünde Hajcsik** dhe **Patricia Rusak**. Nuk mund të them epitet tjetër për to: të shkëlqyera. Publiku është në një mendje me mua, rrezatimi i tyre i bukur vlerësohet nga vëmendja dhe qetësia e madhe. Përhëndesin në gjuhën e tyre turmën festuese, pastaj prezantojnë përkthyesen **Agnes Tomka** e cila ua përcjell të gjithëve mesazhet e lektorëve të kësaj dite.





I pari në skenë thërritet drejtori gjeneral i rajonit **Dr. Sandor Mílesz** bashkë me drejtorin rajonal të Bosnia-Hercegovinës **Dr. Slavko Paleksić** dhe drejtuesen e zyrës së Sarajevës **Enra Hadžović**. Drejtori gjeneral e falenderon me fjalë lavdëruese, kurse publiku me duatrokitje të mëdha punën e drejtuesve vendas me të cilën krijuan këtë atmosferë të shkëlqyer festive. Përshëndetja e Dr. Sandor Mílesz-it është nxitje e vërtetë. Thotë se mund t'u ofroj të gjithëve – edhe milionerëve – mundësi të cilat sjellin dinamizëm në jetën e tyre. Pastaj përmend me radhë programet motivuese: udhëtimet në Denver, Poreç, Vienë, çeqet që mund të arrihen në programin e ndarjes së profitit. Tregon që sot, këtu në Sarajevë mund ta dëgjojmë nga lektorët më të mirë të Europës, madje të gjithë botës se si mund t'i realizojmë këto pikësynime. Falenderon për mikpritjen drejtorin rajonal **Slavko Paleksić**. „Le të filloj show!” – me këtë thirrje përshëndet dhe largohet nga skena i shoqëruar nga brohoritjet që s'kanë pushim të të mbledhurve.

Lektori i parë profesional është senior menaxheri me qarkullimin më të madh në Bosnie-Hercegovinë, i cili – siç merret vesh – s'është vetëm babai, por tashmë edhe sponsori i dy fëmijëve të tij, ky është **Vaselije Njegovanović**. Dinamizmin e leksionit të tij me titull „Përse jemi këtu?” përpiqet ta thyejnë vetëm duatrokitjet gjithmonë e më të shpeshta – por pa sukses.

Pas kësaj drejtori rajonal Slavko Paleksić thërret në skenë supervisorët dhe asistent menaxherët e kualifikuar në muajin e kaluar që të marrin nga dora e drejtorit gjeneral Dr. Sandor Mílesz medaljet e tyre të merituar. Dhe gjatë fotografimit të përbashkët buzëqeshin shumë fytyra të lumtura e të prekura! Drejtuesja e programit Patricia Rusak e prezanton lektoren e ardhshme si shembullin e saj personal. Senior menaxherja dhe anëtarja e President's Club, **Agnes Klaj** ka arritur dhe realizuar gjithçka që mund të arrihet gjatë gjashtë viteve.





Në leksionin e saj tregon se përveç fëmijëve të saj gjithçka ia falenderon Forever-it. Tregon si shembull karrierën e vet, të ilustruar me pamje nga jeta e saj. Jo vetëm fjalët, por edhe veprat e saj tregojnë qetësinë e vendimit të saj. Na nxit që të mos e shtyjmë marrjen e vendimit për të ndryshuar rrugën e jetës sonë. Në skenë ngjitet soaring menaxheri dhe anëtar i President's Club, **Sandor Toth**, si monumenti i gjallë i durimit dhe këmbënguljes. Prej tij mund ta mësojmë se si mund të ndërtohet në mënyrë sistematike ky biznes. „Nëse bën atë që nuk e bëjnë të tjerët, njëherë në të ardhmen mund të bësh atë që të tjerët nuk e bëjnë dot!”

Për përpunimin e këtij mesazhi shfaqja e **Grupit Muzikor dhe Kërcimtar Android** na ofron një argëtim që të shplohë shpirtin. Publiku e shpërblen me brohoritje dhe duartrokitje entuziaste koreografinë dinamike të artistëve hungarez. Pas kësaj shfaqje duar të zota e ndryshojnë menjëherë skenën. Publikut nuk i mbet kohë të zgjohet kur menjëherë mund t'i hedh një shikim një salloni kozmetik dhe parukerie. Me drejtimin e senior menaxhereve **Tünde Hajcsik** dhe **Patricia Rusak** prezantohet një show Sonya i veçantë. Kolegët paruker, kozmetik dhe ngjyruer trupi me duar të shkathta me lëvizje të lehta – si dhe me produktet me cilësi të shkëlqyer të Forever-it – bëjnë magji përpara syve tanë! Është kënaqësi për mua që mund të provoj një eksperiencë të tillë. Nuk i kam zili ata që heqin dorë nga kjo pamje dhe janë të detyruar të qëndrojnë në botën prozaike të mbajtjes shënim. Megjithatë është padyshim me vlerë! Këtu dëgjojen shumë rekomandime të mira, marifete të imta





kozmetike dhe këshilla biznesi. „Të bëjmë markë dhe të krijojmë biznesin tonë!” – dëgjohet mesazhi i fundit motivues i shfaqjes. Nga kjo botë e bukurisë organizuesit nuk na kthejnë menjëherë në botën e biznesit. Shijojmë shfaqjen tjetër spektakolare të Grupit Muzikor dhe Kërcimtar Android. Duetrokita me të cilën vlerësohet shfaqja e tyre është edhe më e fuqishme se e para. Pason një nga pikat kulminante të ditës: vlerësimi i menaxherëve, menaxherëve drejtues, pastaj i të kualifikuarve të Klubit të Sundimtarëve dhe programit motivues të makinës, ndërkohë që në sfond Goombay Dance Band këndon rreth ëndrrës së artë të Eldorados. Të kualifikuarit imagjinojnë ëndrrat e arta, ndërkohë që turma që i duartroket ata konkurron me tonin e teknikës së studios. Jo më kot!

Atmosfera festive e kualifikimeve ndiqet nga këngë popullore vendase.

Publiku përshëndet një lektor vendas. Senior menaxheri dhe anëtar i President's Club **Safet Mustafić** flet rreth mënyrës se si arriti që sot të ketë biznesin që zhvillohet më shpejt. Atmosfera entuziazmohet mëtej nga grupi me famë botërore i valles popullore të Bosnia-Hercegovinës, **Bosansko Kolo**.

Diamant-safir menaxherja **Aranka Vagasi** ndan me dëgjuesit përvojat e saj trembëdhjetë vjeçare të ndërtimit të biznesit. „Nuk duhet ta pranojmë që suksesi nuk na përket ne! Na përket! Dhe e arrijmë!” – shpjegon kuptimin e këmbënguljes, pastaj aktiviteti përfundon me kualifikimin e asistent supervisorëve.



DITA E SUKSESIT - ZAGREB

# Success Day



## KORIERËT

Çdo Ditë Suksesi është një histori sukcesi e njerëzve të zotë të cilët i marrin përsipër sfidat. Një histori e pafund e cila fillon nëpërmjet nesh dhe vazhdon me ne. Personazhet e saj janë njerëz të vlerësuar nga shoqëria të cilët kanë fituar respekt dhe personalitetet me anë të kryrjes në mënyrë cilësore të detyrave të tyre. Një histori rreth njerëzve të vullnetshëm dhe me vlerë të cilët janë gjithmonë të gatshëm për të arritur pikësynimet e tyre, të cilët i përcjellin me çiltërsi njohuritë dhe përvojat e tyre, duke ndihmuar në këtë mënyrë të tjerët që edhe ata të nisen në rrugën e shkelur prej tyre – në rrugën e suksesit.







**D**rejtuesja e Ditës së Suksesit të kaluar të Zagrebit ishte menaxherja nga Rijeka **Andrea Žantev** e cila tregoi me shumë entuziazëm rreth historisë së suksesit të saj. Andrea kishte një pamje rreth të ardhmes të cilën më në fund e realizoi. U diplomua si inxhinierë navale, pastaj punoi si përfaqësuese e disa firmave të njohura kozmetike. Kurse në shpirt është sportiste dhe adhuruese e natyrës. Siç tregoi më parë nuk ishte e kënaqur me firmën ku punonte. Por përse zgjodhi pikërisht FLP-n pas statutit dhjetë vjeçar të blerësit? Përveç produkteve të shkëlqyera ndikoi shumë edhe shembulli i çiftit, rritjen e të cilit e ndiqte vazhdimisht dhe e shtytur nga shembulli i tyre vendosi ta nis edhe ajo. Mësoi shumë, punoi dhe ndoqi me vëmendje sponsorin e saj. Andrea sot ka ndryshuar, edhe jeta e saj gjithashtu – pamja e të ardhmes iu bë më e qartë. Kur u kthye nga Rally i Londrës, e mbushur plot me motivim i ngriti edhe më lart pikësynimet e saj, rreth të cilave sivjet do të dëgjojmë me siguri. I urojmë suksese të shumta në arritjen e pikësynimeve të saj!

**Tina Rupčić** është një nga zërat më të bukur të muzikës së rajonit. Karrierën e saj e nisi në grupin **Maxmett**, pastaj u bë zëri shoqërues i grupit „Parni valjak”. Kënga e Tinës dhe kitarja e Vedinit na magjepsën me baladat e mrekullueshme të Valjak-ut të njohur. Të rejat e zyrës u bënë të njohura nga **Laszlo Molnar** i cili beson në faktin që kushdo mund të përparojë në jetë: kjo u bë motoja e tij. Mendon se edhe lajmet e mira na motivojnë. Pasi përshëndeti lektorët dhe mysafirët, përgëzoi skuadrën e Rijekës për rezultatet e mrekullueshme të arritura, duke thënë se puna e tyre bën përpjetë në mënyrë të dukshme. Falenderoi Andrean për raportin rreth Rallyt European të Londrës, pastaj i nxiti punonjësit të kualifikohen për në Rallyn European të 2010 në Vienë. Dhe natyrisht kemi edhe Holiday Rallyn e Poreçit, të cilin sivjet e organizojmë dy herë: në qershor, pastaj në shtator. Mjafton që nga niveli i asistent menaxherit të ngjitemi vetëm një shkallë më lart: shpërblimi është një aktivitet katër ditor plot me mësim, shoqëri dhe

argëtim. Por Laszlo i ftoi punonjësit edhe në trainimin Start – kjo është një formë e re trainimi, të cilin e organizojmë çdo dy muaj në zyrën qendrore të Zagrebit.

**Ivan Ciler** është përfaqësues i mënyrës së shëndetshme të jetesës, dhe këtë e ndërli dhi në mënyrë të shkëlqyer me firmën që prodhon produkte të shkëlqyera. Sipas tij FLP është firma më e ndershme MLM dhe biznesi më i organizuar i Kroacisë. Dhe përse është më e mira pikërisht aloe e FLP-s? Nga kultivimi ekologjik deri tek plehërimi natyror, nga përpunimi deri tek stabilizimi, nga siguria e cilësisë deri tek paketimi dhe depozitimi – të gjitha këto kontribuojnë që të nxjerrim më të mirën në treg. Ivan i mbështeti thëniet në leksionin e tij me shumë ilustrime dhe xhirime, duke prezantuar produktet, kushtet e prodhimit, depozitimit dhe qarkullimit. Bëri të njohur çertifikatat e cilësisë, standartin ISO dhe HACCP, standartin e pastërtisë kosher dhe islamike.

Tina dhe Vedin me një buqetë të re këngësh na çuan në një botë tjetër, dhe ishte e natyrshme që edhe ne kënduam bashkë me ta. Me zërin dhe shfaqjen e saj të mrekullueshme Tina na magjepsi plotësisht.

Falë **Mr. Marija Novak Ištok** shumë njerëz e ndryshuan mendimin e tyre në lidhje me MLM-n. Ndryshoi qëndrimi i gjithë atyre që e shikonin shitjen e drejtpërdrejtë si një veprimtari që përmban energji dhe mendime negativë. Mr. Novak e di mirë se për çfarë flet. Diplomën dhe masterin e tij e morri në degën e marketingut. Merret me kulturën e biznesit, komunikim dhe marketing direkt, dhe e kalon kohën me seminare MLM, projekte dhe libra mësimor. Në leksion e sotëm foli rreth mënyrës se si të ftojme të tjerët në prezantime. Nuk mjafton dëshira, energjia, ëndrrat dhe lista e emrave, pa këtë nuk mund të kemi sukses. Marija na e bëri të qartë realitetin: nëse nuk shesim, nuk paguhemi, pa porosi s'ka shitje, pa bisedime shitjesh s'ka porositje. Dhe natyrisht pa ftesë s'ka bisedime shitjesh. Gjithçka fillon me këtë hap të rëndësishëm. Dëgjuam një leksion interesant dhe mësimdhënës.





Përvojat e konsumatorëve me produktet janë shumë të rëndësishme, pasi suksesi i firmës sonë bazohet në cilësinë e produkteve. Firma ndodhet në 146 shtete të botës dhe në çdo vend shkojnë nëpërmjet përvojave me produktet. Lajmi i mirë rreth efektivitetit të produkteve i nxit edhe të tjerët që t'i konsumojnë. Përvojat me produktet u bënë të njohura nga senior menaxherja dhe mjekja **Dr. Branka Molnár Stantić**. Dr. Molnár zotëron një personalitet serioz dhe njohuri të mëdha profesionale, kështu që i njeh mirë edhe efektet e produkteve FLP. Shpjegon me hollësi se çdo të thotë të jesh konsumator i produkteve FLP. Pas leksionit çifti Molnár u dorëzoi supervizorëve, asistent menaxherëve dhe menaxherëve të rinj medaljet e tyre. Shpallën edhe dhjetë punonjësit më të mirë në bazë të pikëve të distributorit. Në skenë gëzonin së bashku të kualifikuarit dhe sponsorët e tyre, dhe natyrisht edhe punonjësit që u sollën këtu nga të kualifikuarit.

Asistent menaxherja **Bojana Pavić** megjithëse u nis në rrugën e suksesit, është e bindur që ndodhet vetëm në fillim të saj. „S'ka rëndësi prej sa kohësh ndodhemi tek një firmë, s'ka rëndësi çfarë niveli arrijmë, të gjithë ndodhen vetëm në fillim të rrugës, pasi FLP na ofron gjithmonë mundësi të reja” – shpjegoi ajo. Si masazhatore dhe mjeshtrë kozmetike u magjeps nga produktet, pastaj me kalimin e kohës e kuptoi që kjo punë i siguron asaj edhe të ardhura të mira. Me vajzën dhe burrin e saj, Ante – i cili e mbështet në këtë punë – shpresojnë të arrijnë rezultate të jashtëzakonshme. Bojana foli rreth nisjes, rreth asaj që e motivoi,

dhe si arriti „të infektoj” edhe burrin e saj. Shfaqej për herë të parë në skenë në jetën e saj, por i magjepsi të gjithë me thjeshtësinë dhe leksionin e saj. I urojmë suksese të shumta Bojanës!

Mysafiri ynë **Tamas Biro** ka patur gjithmonë guxim të hedh hapa të reja. Kurse ne mësojmë gjithmonë me kënaqësi prej njerëzve të suksesshëm. Tamas tregoi që pavarësisht nga situatat e vështira të jetës ka patur gjithmonë besim në vetvete, dhe ka shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga FLP-ja, mundësitë e jashtëzakonshme për njerëzit e zakonshëm. U nis drejt pikësnyimeve dhe s'ka hequr asnjëherë dorë prej ëndrrave të tij. Bashkë me gruan e tij Diana tani ndodhen në nivelin e soaring menaxherit, por të gjithë e nisim nga fillimi. Vetëm mësimi i vazhdueshëm na çon përpara, dhe për këtë Turbo start është një mundësi nisjeje. Ne jemi korrierë, themi të vërtetën tonë, jemi krenar për drejtuesit e firmës dhe njohuritë me të cilat na sigurojnë mundësi të pabesueshme. Të falenderojmë Tamas për leksionin motivues i cili na nxit për të mësuar dhe për të qenë së bashku, i cili na jep vrull të ri.

Ashtu si gjithmonë edhe këtë Ditë Suksesi e mbyllëm duke falenderuan drejtuesin e programit dhe lektorët, pastaj u dorëzuam medaljen e shqiptonjës asistent supervizorëve të rinj. Shpresojmë që leksionet e dëguara dhe personaliteti i lektorëve i motivon në mënyrën e duhur ata që të ndryshojnë jetën e tyre dhe të ndjekin rrugën e suksesit.

**Mr. sc. Laszlo Molnár**  
inxhinier i diplomuar, drejtor rajonal



# PËRSËRI KAMPIME KALORËSIMI GJATË PUSHIMEVE VERORE NË HOTELIN E KËSHTJELLËS SË SZIRAKIT

Informacione të mëtejshme!: Telefon: 06-32-485-300 Web: [www.kastelyszirak.info](http://www.kastelyszirak.info)

Kampimi zhvillohet në turne prej 5 ditësh/4 netësh në stallën e kuajve dhe territoret e tjera që i përkasin Hotelit Kështjella e Szirakit.

Pjesëmarrësit e kampimit të kalorësimit janë fëmijë të moshës 9-16 vjeç. Programi fillon në orën 9 të mëngjesit deri në orën 16. Gjatë ditës pjesëmarrësit mund të ulen dy herë mbi kalë dhe mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në punën me kuajt.

Mundësi të tjera programesh: wellness dhe fushë tenisi, tenis tavoline, badminton, bowling.


Çmimi i kampit ditor duke përfshirë trainerin, shërbimin dhe përdorimin e wellness: 3900 Ft/person/ditë. Bashkë me strehimin: 35000 Ft/person/turn (Çmimet përmbajnë edhe tvsh-n.)

Turnet i nisim në rastin e paraqitjes së të paktën 6 personave!

Pranojmë edhe çeqe pushimi!

## TURNET

21. 06.–25. 06. 2010  
28. 06.–02. 07. 2010  
19. 07.–23. 07. 2010  
26. 07.–30. 07. 2010  
02. 08.–06. 08. 2010  
09. 08.–13. 08. 2010



## TAKIM MENAXHERËSH

11.00 ARDHJA, MBLEDHJA  
E PJESËMARRËSVE  
11.45 HAPJA E EKSPOZITËS  
HORTHY - TELEKI  
12.00 DREKË



13.00 PËRSHËNDETJE – DR. SANDOR MILESZ



13.00 RAPORT RRETH WORLD RALLY

PETER LENKEY DREJTORI OPERATIV I EUROPËS, MIKLOS BERKICS DIAMANT-SAFIR MENAXHER, VERONIKA LOMJANSKI DHE STEVAN LOMJANSKI DIAMANT MENAXHERË, DR. ADOLF L. KOSA SAFIR MENAXHER, TOMISLAV BRUMEC DHE ANDREJA BRUMEC SOARING MENAXHERË, SI DHE ATILA GIDOFALVI DHE GIDOFALVI ATTILANE DIAMANT-SAFIR MENAXHERË



14.00 PËRSHËNDETJE – AIDAN O'HARE DREJTUES I EUROPËS



15.00 KLASIKËT E FOREVER-IT

„NË PODIUM EDHE NË PROFIT SHARING” – ARANKA VAGASI DIAMANT-SAFIR MENAXHER, DHE BOTOND KOVACS MENAXHER

„MË PËLQEN TË JEM DREJTUES” – MIKLOS BERKICS DIAMANT-SAFIR MENAXHER

„BËHUNI DIAMANTI” – VERONIKA LOMJANSKI DIAMANT MENAXHERE



REX MAUGHAN KRIJUESI DHE DREJTUESI I PËRGJITHSHËM I FOREVER LIVING PRODUCTS

19.00 DARKË

# PËRVJETORI I 13-TË SUCCESS

6 QERSHOR 2010

## PROGRAMI



PËRSHËNETJE  
**DR. SANDOR MILESZ**  
DREJTOR GJENERAL



PËRSHËNETJE  
**PETER LENKEY**  
DREJTORI OPERATIV I EUROPËS



TÜNDE HAJCSIK SENIOR, DIANA BIRO SOARING DHE  
PATRICIA RUSAK SENIOR MENAXHERE – DREJTUESE PROGRAMI

### ANDROID

MBROTJE SHËNDETI NË VERË – **DR. ILONA JURONICS DR. VARGANE** MENAXHERE

### YJE

PËRVOJA ME PRODUKTE – SPECIALISTËT TANË MJEK 30'

**AIDAN O'HARE**  
DRJETORI I EUROPËS

KUALIFIKIMI I SUPERVIZORËVE, ASISTENT MENAXHERËVE

LEKSIONI I KLASIKËVE TË FOREVER-IT:

NDËRTIM SKUADRE NË SHKALLË TË LARTË – **DR. ADOLF L. KOSA** SAFIR MENAXHER  
PËRGATITEMI PËR NË EU RALLY DHE HOLIDAY RALLY – **ISTVAN HALMI** SAFIR MENAXHER

### SONYA – ANDROID

KUALIFIKIMI I MENAXHERËVE, DHËNIA E TARGAVE, KUALIFIKIMI I MENAXHERËVE DREJTUES,  
KUALIFIKIMI I BUSINESS BUILDERS, SUPER RALLY DHE HOLIDAY RALLY

VLERA E PROFIT SHARING – **ARANKA VAGASI** DIAMANT-SAFIR MENAXHERE

### YJE

KËRKOJ BASHKËPUNONJËS TË RINJ – **ROBERT VARGA** DIAMANT-SAFIR MENAXHER  
DO TË BËHEM DIAMANT – **MIKLOS BERKICS** DIAMANT-SAFIR MENAXHER  
SI ANËTARE E KLUBIT TË DIAMANTËVE – **VERONIKA LOMJANSKI** DIAMANT MENAXHERE

YJE – SHPALLJE REZULTATI

KUALIFIKIMI I ASISTENT SUPERVIZORËVE

I PRESIM ME KËNAQËSI TË GJITHË NË ORËN 10.00 NË ARENËN SPORTIVE TË BUDAPESTIT  
(1143 BUDAPEST, STEEFÁNIA ÚT 2.)

FOREVER

# CONQUISTADOR

## TOP 10 CLUB

### HUNGARIA



1. **SIKLÓSNÉ DR. RÉVÉSZ EDIT**  
**SIKLÓS ZOLTÁN**
2. **NAGY ÁDÁM**  
**NAGYNÉ BELÉNYI BRIGITTA**
3. **ÉLIÁS TIBOR**
4. **VISNOVSZKY RAMÓNA**  
**BOGNÁR GÁBOR**
5. **SZABÓ BÁLINTNÉ**  
**SZABÓ BÁLINT**
6. **VÁRADI ÉVA**
7. **GÖRBICS ORSOLYA JUDIT**  
**DEMCSÁK L. MIKLÓS**
8. **RIGÓ LAJOS**  
**RIGÓNÉ SÁNDOR LENKE**
9. **LAPICZ TIBOR**  
**LAPICZNÉ LENKÓ ORSOLYA**
10. **DR. SERESNÉ DR. PIRKHOFFER KATALIN**  
**DR. SERES ENDRE**

### SERBIA

1. **VIOLETA PUJOVIĆ**
2. **MIODRAG UGRENOVIĆ**  
**OLGA UGRENOVIĆ**
3. **GORDANA VUKAJLOVIĆ**
4. **DR. MARIJA RATKOVIĆ**
5. **MILANKA MILOVANOVIĆ**  
**MILISAV MILOVANOVIĆ**
6. **BOROS GYEVÍ TIBOR**
7. **SUZANA PETROVIĆ**  
**DRAGAN PETROVIĆ**
8. **DR. SONJA JOVIĆ RANDJELOVIĆ**  
**DRAGAN RANDJELOVIĆ**
9. **ALEKSANDAR RADOVIĆ**  
**DANA RADOVIĆ**
10. **SLOBODAN ANTONIJEVIĆ**  
**BILJANA ANTONIJEVIĆ**



DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM  
TË MUAJIT MARS 2010 NË  
BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT

KROACIA



1. ZLATKO JUROVIĆ  
SONJA JUROVIĆ
2. NEDELJKO BANIĆ  
ANICA BANIĆ
- 3 JASMINKA PETROVIĆ  
MIRKO PETROVIĆ
4. TIHOMIR STILIN  
MAJA STILIN
5. ANDREA ZANTEV
- 6 ELVISA ROGIĆ  
JAKOV ROGIĆ
- 7 DUBRAVKA CALUŠIĆ  
ANTE CALUŠIĆ
8. IVAN LESINGER  
DANICA LESINGER
9. JASNA KVATERNIK JANKOVIĆ  
IVICA JANKOVIĆ
10. IVANKA MILJAK RILL  
ROLF RILL

BOSNIA-HERCEGOVINA

1. MUSTAFIĆ SUBHIJA  
MUSTAFIĆ SAFET
2. ZEČIR CRNČEVIĆ  
SAMIRA CRNČEVIĆ
3. DŽEVAD DŽAFEROVIĆ  
ALBINA DŽAFEROVIĆ
4. DR. GORAN FRANJIĆ
5. DR. NEDIM BAHTIĆ  
BELMA BAHTIĆ
6. SVETLANA NJEGOVIĆ
7. ZORAN NJEGOVIĆ
8. ZORAN VARAJIĆ  
SNEŽANA VARAJIĆ
9. GAIBIJA ČATIĆ  
MUNIRA ČATIĆ
10. DANIJEL MARKOVIĆ



SLLOVENIA



1. JOŽEFA ZORE
2. RINALDA ISKRA  
LUČANO ISKRA
3. STANISLAVA VINŠEK
4. BRIGITA MOHORIĆ
5. DR. SREČKO HERLIĆ
6. LOVRO BRUMEC
7. DANICA GODEC
8. JUSTINA KUDER  
VINKO KUDER
9. KARMEN SLIBAR
10. NADJA KRIZMAN  
FRANC KRIZMAN





## NIVELIN E MANAGER-IT E ARRITËN



### Rigó Lajos & Rigóné Sándor Lenke

(Sponsorët e tyre: Szabó Bálintné dhe Szabó Bálint)

„FLP ju dha atyre mundësinë që të arrijnë suksese dhe pikësynimet e tyre edhe në një lloj tjetër biznesi. Është një ndjenjë e mrekullueshme të punosh në një skuadër ku të gjithë kanë ëndrra, dhe prandaj mund të punojmë së bashku si një njeri i vetëm. Falenderojmë sponsorët tanë të cilët na e bënë të njohur këtë mundësi fantastike.

Falenderojmë Robert Varga-n për udhëzimet, Sandor Nemeth-in dhe gruan e tij Edit për ndihmën e dhënë në arritjen e rezultateve tona, si dhe gjithë anëtarët e skuadrës sonë që kontribuan në sukseset tona.”



## NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Nedjeljko Banić & Anica Banić  
Máthé Zsolt & Horváth Éva  
Meggyesi Imre  
& Meggyesiné Kántor Tamara  
Violeta Pujović  
Szemenyei Ervinné

Durda Lukić  
Judita Majorosova & Jacint Majoros  
Németh Bence  
Nagyfejeő Péterné & Nagyfejeő Péter  
Péntek Józsefné & Tóth Zoltán  
Suzana Petrović & Dragan Petrović  
Románné Dornek Ildikó  
Somogyi Józsefné  
Szadainé Szécsényi Szilvia & Szadai Zsolt  
Tollár Nóra  
Varga Gábor

Czeléné Gergely Zsófia  
Csepi Ildikó & Kovács Gábor  
Csuka György  
& dr. Bagoly Ibolya  
Csürke Bálint Géza  
& Csürke Bálintné  
Dobsa Attila  
& Dobsáné Csáki Mónika  
Goran Dragojević  
& Irena Dragojević  
Éliás Tibor  
Dr. Farády Zoltán  
& dr. Farády Zoltánné  
Farkas Gáborné & Farkas Gábor  
Fittler Diána  
Anton Gajdo & Olivia Gajdo  
Gecző Éva Krisztina  
Gecző László Zsoltné  
& Gecző László Zsolt  
Gecse Andrea  
Haim Józsefné & Haim József  
Hajcsik Tünde & Láng András  
Halomhegyi Vilmos  
Heinbach József & dr. Nika Erzsébet  
Hofbauer Rita & Gavalovics Gábor  
Illyés Ilona  
Jancsik Melinda  
Jozó Zsolt & Molnár Judit  
Dr. Kálmánchey Albertné  
& dr. Kálmánchey Albert  
Dr. Kardos Lajos  
& dr. Kardosné Hosszú Erzsébet  
Kása István & Kása Istvánné  
Kemenczei Vince & Tamási Krisztina



## NIVELIN E SUPERVISOR-IT E ARRITËN

Badurina Edvard  
Balatincz Balázs  
Birta László & Birta Lászlóné  
Bóta Gábor & Bóta Gáborné  
Csehné Nádudvari Katalin  
Csendes Sándor  
Davis Erika  
Dr. Jurij Volkov  
Farkasovszki Viktor  
Gaál Varga Jolán & Gaál Imre  
Hambek Anita  
Kántor Attiláné  
Ljubica Katava  
Katona Gézánné  
Katona Zsolt & Hircsu Nóra  
